Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Shkelzen Hoxha	**09.08.2023**	**17.08.2023**	**2023/0551**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.08.2023 OE N.T.P "Bletaria Egzoni" Gjakovë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0551, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është rekomanduar për kontratë OE N.T.P "Bajra", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Blerja e pajisjeve bletare" me nr. të prokurimit: 612-23-6052-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10.3 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

Njoftimi për Kontratë është bërë me dt. 13.06.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me d
04.07.2023, ku kanë qenë 3 ofertues .

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt. 06.07.2023 ku është rekomanduar p
kontratë OE N.T.SH. BLETA, kurse neve na është dërguar letra standarde për tenderues
pasuksesshëm. Ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.11.07.2023, ku kemi parashtru

pretendime ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë N.T.SH. BLETA dhe OE
pasuksesshëm N.P.T. Bajra, ndërsa me dt.17.07.2023 është publikuar vendimi për aprovim
pjesërishëm të kërkesës tonë për rishqyrtim.

Me dt.17.07.2023 përsëri është publikuar njoftimi mbi vendimin, ndërsa tani është rekomanduar p
kontratë OE N.P.T. Bajra, ku për të njëjtin OE, në vendimin për aprovim të kërkesës për rishqyrti
është cekur janë kërkuar sqarime shtesë dhe e ka sjell testin antivaro.

Ju sqarojmë se është rekomanduar për kontratë N.P.T. Bajra i cili është i papërgjegjshëm për fakt
si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë në ofertë ka dorëzuar dy dokumente të cilat i ka emëruar si A-test
mirëpo në brendësi të tyre dokumentet në fjalë janë të emërtuara si Rregullore dhe jo A-teste.
Duke pasur parasysh këtë dëshmi kuptohet se i njëjti OE nuk ka ofruar A-teste dhe është
papërgjegjshëm.
Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë në ofertë, ka prezantuar një dokument A-testit të lëshua
nga kompania CHI MEI CORPORATION, i lëshuar me dt.01.01.2018 i cili ka validitet vetëm 1
muaj.
Nga ky fakt kuptohet se është prezantuar një A-test jo valid.
Duke pasur parasysh këto dëshmi ku kuptohet që OE i rekomanduar për kontratë është
papërgjegjshëm, atëherë nuk mund dhe nuk është dashur në asnjë mënyrë të kërkohen sqarime shtes
nga ky operator ekonomik mirëpo i njëjti është dashur të shpallet automatikisht i papërgjegjshëm
Me këtë veprim të AK-së është favorizuar operator ekonomik i rekomanduar për kontratë i cili ésht
i papërgjegjshëm.

Në vendimin për aprovim të pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtim është cekur se pretendimet ton kundrejt OE tani të rekomanduar për kontratë nuk qëndrojnë pasi që të njëjtit i janë kërkuar sqarim shtesë dhe i njëjti i ka prezantuar A-testet.
Në këtë rast autoriteti kontraktues nuk mund dhe nuk është dashur të kërkojë sqarime shtesë në lidhj me A-testet, për shkak se A-testet në këtë rast bëjnë pjesë tek specifikimet teknike të detyrueshme pra A-testet janë kërkuar për plastikën tek specifikimet teknike pas sqarimeve te TD.
Përderisa OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka prezantuar A-testet, ligjërisht nuk është dashur t kërkohen sqarime shtesë në lidhje me specifikimet teknike të detyrueshme, sepse ofrimi i dëshmiv të tjera e që nuk janë prezantuar me dosje të tenderit përbën ndryshim substancial dhe material.

Përveç faktit që ky OE është i papërgjegjshëm dhe A-testet e prezantuara pas kërkesës për sqarim shtesë nuk është dashur ti merren parasysh e për më tepër nuk është dashur ti kërkohen as sqarime shtesë, për të njëjtat A-Teste është dashur të prezantohet edhe kontrata ose autorizimi që i njëjti O është i autorizuar nga prodhuesi të ofertoj me produktet e tij. Në A-testet e prezantuara nuk figuro askund emri i OE të rekomanduar për kontratë dhe i njëjti është dashur të prezantoj autorizimin ng prodhuesi përmes të cilit do të vërtetohej fakti që ky OE është i autorizuar të bëj shitjen e produktev të tilla.

Gjithashtu autoriteti kontraktues përsëri nuk e ka respektuar nenin 10.3 të LPP-së, pasi që nuk na k ofruar të gjitha dokumentet rreth kërkesave eventuale për sqarime.

Autoriteti kontraktues nuk na ka ofrua kërkesën për sqarime të cilën e ka bërë për OE e rekomandua për kontratë, e as përgjigjen e tyre, mirëpo na i ka dhënë A-testet e të njëjtit vetëm fizikisht.

Kërkojmë nga eksperti shqyrtues që ti analizojë të gjitha shkresat dhe të konstatohet se a janë kërkua sqarimet në formë elektronike (përmes e prokurimit) sipas ligjit, pasi që ne jemi të interesuar të dijm se përse dhe me çfarë arsyetimi janë kërkuar sqarime shtesë përderisa OE i rekomanduar për kontrat i ka prezantuar me ofertë A-Testet, të cilat nuk kanë qenë konform specifikave të kërkuara.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësua edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku kërkesë ka qenë *"1.Operatori Ekonomik duhet të ofro dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga dat e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 22 500 euro.Ne rast te grupit lideri duhet kete se paku 60 % te shumes se kerkuar furnizime te natyres se ngjajshme"*, ndërsa si dëshm dokumentare është kërkuar *"1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsua produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkates ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje"*.

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar në ofertë disa kontrata të cilat nuk kanë të bëjnë far me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, pra nuk janë të natyrës së ngjashme me këtë aktivitet t prokurimit.
Përveç kontratave me furnizim me paisje bujqësore etj, i njëjti në ofertë ka prezantuar edhe nj kontratë-Furnizimi me koshere për Bletë, në vlerën 9,113.00 euro, e realizuar me një kompar private Komtel Project Engineering SH.P.K.
Për kontratën e lartcekur i njëjti OE ka prezantuar një kontratë të lidhur me kompaninë Komte Project Engineering SH.P.K., dhe një referencë të lëshuar nga e njëjta kompani, mirëpo ne dyshojm që kontrata e tillë është fiktive.
Dyshimet tona bazohen në faktin se kur analizohen të dhënat e kompanisë Komtel Projec Engineering SH.P.K., shihet që e njëjta si aktivitet primar ka -Kërkime dhe zhvillime të tjer eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri, ndërsa si aktivitet sekondar - Aktivitetet programimit kompjuterik.

Gjithashtu kjo kontratë nuk mund të merret parasysh pasi që brenda në kontratë figuron se kompar Komtel Project Engineering SH.P.K., ka bërë furnizimin tek OE Bajra dhe jo e kundërta. Ndërsa n referencën e lëshuar nga Komtel shkruan ndryshe, pra në këtë rast ka mospërputhje në mes referencë dhe kontratës, andaj dyshimet tona që kjo kontratë është fiktive janë të qëndrueshme.

Edhe përkundër faktit që janë prezantuar disa transaksione bankare ndërmjet dy kompanive, pë asnjërin nga transaksionet nuk janë prezantuar faturat, pasi që në fatura shënohet se çfarë llo shërbimi është kryer, ndërsa me transaksionet e prezantuara nuk mund të vërtetohet fakti se a ësht përfunduar një kontratë e tillë, apo këto transaksione janë për krejt diçka tjetër.

Po ashtu përveç kontratës së lartcekur, i njëjti OE në listën e kontratave i figuron edhe një kontrat e lidhur me OE FAMIS-CO Holding, në vlerë 34,541.80 euro. Për këtë aktivitet OE i rekomandua për kontratë ka prezantuar një referencë e cila është e lëshuar nga FAMIS-CO Holding, mirëpo n edhe për këtë referencë kemi dyshimet tona që e njëjta është fiktive.

Dyshimet tona bazohen në faktin se kur analizohen të dhënat e kompanisë FAMIS-CO - HC SH.A shihet që e njëjta si aktivitet primar ka - Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore, ndërsa s aktivitet sekondar - Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi.
Po ashtu dyshimet tona rriten edhe më shumë kur analizohet referenca e lëshuar nga FAMIS-CO HC SH.A, pasi që askund në referencë nuk figuron titulli i projektit të cilin e ka prezantuar në list të kontratave OE i rekomanduar për kontratë. Gjithashtu askund në referencë nuk shkruan s furnizimet janë bërë për fushën e bletarisë apo ndonjë gjë e tillë.

Në lidhje me këtë referencë ne konsiderojmë se duhet të prezantohet kontrata e lidhur në mes të O të rekomanduar për kontratë dhe OE FAMIS-CO - HC SH.A., gjithashtu konsiderojmë se duhet t prezantohen edhe transaksionet bankare së bashku me fatura, pasi që siç edhe e cekëm ne dyshojm që kontrata me titull "Furnizim me pajisje për bujqësi dhe bletari" nuk ka ekzistuar fare, pra ësht kontratë fiktive.

Ndërsa kontratat tjera të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk mund dhe nuk duhet t merren parasysh pasi që nuk janë të natyrës së ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit. Kontrata që kanë të bëjnë me furnizime me pajisje-kositëse bari, me pompa uji për zjarrfikës, furnizime m pjesë rezervë për makina kositëse etj, nuk duhet të cilësohen si kontrata të ngjashme me natyrë "Blerja e pajisjeve Bletare".

Ne me dt.27.07.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku e njëjt është refuzuar me arsyetimin se është e pa bazuar, mirëpo që AK-ja nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret dhe të bazuar në dispozita ligjore.
AK-ja e ka cekur se i ka kërkuar sqarime shtesë OE të rekomanduar për kontratë dhe i njëjti i k ofruar a-testet Antivaro, mirëpo ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar për faktin se në këto raste nu lejohet të kërkohen sqarime shtesë. Përderisa OE i rekomanduar për kontratë me rastin e ofertimi ka prezantuar një a-test i cili ka qenë me afat të skaduar, atëherë kuptohet qartë se në këtë rast nu është përmbushur këkresa e dosjes së tenderit, prandaj nuk është e lejuar të kërkohen sqarime shtes fare.

Pas sqarimeve shtesë OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një A-test nga nj prodhues krejt tjetër me prodhuesin për të cilin e ka prezantuar A-testin e parë, prandaj k fakt përbën ndryshim material dhe substancial.

Përveç faktit që në asnjë dispozitë ligjore nuk specifikohet që lejohen të kërkohen sqarime pë dokumente të cilat janë ofruar përkatësisht dokumente të cilat kanë të bëjnë me specifikime teknike gjithashtu sqarimet e prezantuara nuk është dashur të merren parasysh sepse janë prezantuar a-test krejtësisht tjera, pra nga një prodhues tjetër dhe siç e cekëm ky fakt përbën ndryshim material.

OE i rekomanduar për kontratë në ofertë para se AK-ja të kërkoj sqarime shtesë, ka prezantuar nj dokument (lloj i a-testit) të lëshuar nga kompania CHI MEI CORPORATION, i lëshuar m dt.01.01.2018 i cili ka validitet vetëm 12 muaj. Pra nga ky fakt kuptohet se është prezantuar një A test në ofertë dhe përderisa i njëjti është jo valid, atëherë nuk mund dhe nuk është dashur në asnj mënyrë të kërkohen sqarime shtesë nga ky operator ekonomik mirëpo i njëjti është dashur të shpall si i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se arsyetimi i AK-së në lidhje m pretendimin tonë ankimor është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm.
Autoriteti kontraktues në përgjigjen e saj e ka cekur se e ka respektuar nenin 10.3 të LPP-së, pasi c kinse na ka dhënë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me këtë procedurë dhe se dokumentet r lidhje me sqarimet shtesë janë në platformën e E-Prokurimit, mirëpo ju sqarojmë se edhe ky arsyeti i AK-së është i paqëndrueshëm sepse neve nuk na janë dhënë dëshmitë për sqarime.

Përveç faktit që sqarimet që AK-ja i ka kërkuar OE të rekomanduar për kontratë nuk na janë dhën gjatë qasjes në dokumente edhe pse një gjë të tillë e kemi kërkuar, kur bëhet një kërkim i thjesht tek e-prokurimi askund nuk figurojnë dokumentet e tilla siç ka pretenduar AK-ja. Andaj me këtë ra nuk është respektuar neni 10.3 i LPP-së, pasi që nuk na janë prezantuar të gjitha dokumentet të cil ne i kemi kërkuar gjatë qasjes në dokumente.
Neni 38 i Rregullores Nr.001/2023 për Prokurim Publik e parasheh qarët si në vijim:
38.8 "Kërkesën për sqarim të tenderit" AK duhet t'a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurim elektronik. OE përgjigjen në "Kërkesën për sqarim të tenderit" duhet t'a dërgojë nëpërmjet sistem të prokurimit elektronik.
Kërkojmë që të konstatohet nga eksperti shqyrtues se a janë kërkuar sqarimet në mënyrë elektronik pra a është respektuar neni 38 i Rregullores Nr.001/2023 për Prokurim Publik.
Siç edhe e kemi cekur neve na janë dhënë nga ana e AK-së në kopje fizike vetëm a-testet të cilat ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo jo edhe pyetjet që i ka bërë AK-ja ap përgjigjet që i ka dhënë OE i rekomanduar për kontratë.

Sa i përket pretendimit tonë ankimor dhe dyshimeve tona se OE i rekomanduar për kontratë k prezantuar kontrata fiktive, AK-ja e ka cekur se pas kërkesës për sqarime OE i rekomanduar p kontratë i ka prezantuar faturat, kontratat dhe transaksionet bankare dhe se të njëjtat mund ti gjejn në e prokurim.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar për faktin se në platformën e prokurimit askund nuk figuron ndonjë dokument i tillë siç ka pretenduar AK-ja.

Po ashtu AK-ja nuk e ka shqyrtuar pretendimin tonë ankimor në lidhje me kontratën e prezantu nga OE i rekomanduar për kontratë me OE Komtel Project Engineering, ku ne e kemi cekur brenda në kontratë figuron se kompania Komtel Project Engineering SH.P.K, ka bërë furnizimin te OE Bajra dhe jo e kundërta. Ndërsa në referencën e lëshuar nga Komtel shkruan ndryshe, pra në kë rast ka mospërputhje në mes referencës dhe kontratës, andaj dyshimet tona që kjo kontratë ësh fiktive janë të qëndrueshme, pasi që AK-ja nuk është lëshuar fare në këtë pretendim, mirëpo vetë e ka cekur se janë prezantuar faturat mirëpo faturat e tilla nuk na janë prezantuar.

Ndërsa sa i përket kontratës tjetër të OE të rekomanduar për kontratë me OE FAMIS-CO Holdin ne e kemi cekur se edhe referenca e prezantuar nga Famis-Co dyshojmë që është fiktive sepse k analizohen të dhënat e kompanisë FAMIS-CO - HC SH.A., shihet që e njëjta si aktivitet primar ka Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore, ndërsa si aktivitet sekondar - Prodhimi i produktev prej betonit për qëllime ndërtimi.

Po ashtu dyshimet tona se referenca është fiktive rriten edhe më shumë kur analizohet referenca lëshuar nga FAMIS-CO - HC SH.A, pasi që askund në referencë nuk figuron titulli i projektit të cil e ka prezantuar në listë të kontratave OE i rekomanduar për kontratë. Gjithashtu askund në referenc

nuk shkruan se furnizimet janë bërë për fushën e bletarisë apo ndonjë gjë e tillë. Në lidhje me këtë referencë ne kemi kërkuar të na prezantohet kontrata e lidhur në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe OE FAMIS-CO - HC SH.A. dhe transaksionet bankare së bashku me fatura, pasi që si edhe e cekëm ne dyshojmë që kontrata me titull "Furnizim me pajisje për bujqësi dhe bletari" nu ka ekzistuar fare, pra është kontratë fiktive, mirëpo AK-ja nuk na ka ofruar ndonjë dokument të tillë Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, për më tepër është vendim favorizue për OE të rekomanduar për kontratë i cili është i papërgjegjshëm dhe një fakt i tillë është dashur t konstatohet edhe nga AK-ja.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk ësht respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm m çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos n shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorë ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "*Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimi të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me t gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, kurse OE rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihe se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë t shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera t autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerri:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **N.T.P "Bletaria Egzoni"**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin (B58) e AK-së dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dh gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni m kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore n institucionet tjera kompetente

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i Rivlerësimit të ofertave ka hartuar raportin e vlerësimit me datën: 17.07.2023 dhe ka rekomanduar për kontratë N.T.P "Bajra".

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **N.T.P.„Bletaria Egzoni"**

• **Sqarim hyrës**: Autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00€.

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë kundër propozimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Përgjigje në Pretendimet ankimore:

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimore, operatori ekonomik "Bletaria Egzoni" Gjakovë më tej si parashtrues i ankesës, se OE i rekomanduar për kontratë N.T.P "Bajra", lidhur me A-testet, **sqarim:** gjatë fazës së tenderimit për A –teste janë kërkuar me sqarime të dosjes së tenderit me datë: 20/06/2023 nga OE "Bletaria Egzoni" citoj pyetjen e OE-së: 3.Nese Bazamenti Antivaro është nga plastika a kërkohen A-Testet e kryera për plastiken dhe me datën: 20.06.2023 Autoriteti Kontraktues (AK) ka kthyer përgjigjen si citoj: 3. Bazamenti anti varo plastik duhet të ketë A testin e kryer për plastik.

Duke e parë të gjithë materialin lidhur me këtë pretendim vërej se AK nuk e ka bënë Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime duke përdorur formularin standard B54 në harmoni me neni Nenin, 24 Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve sipas RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Por në këtë rast sqarimet të cilat janë bërë nga AK behën pjesë e dosjes së tenderit në cilën do formë.

Ndera lidhur me kërkesë për sqarime në raport me OE për A testet në platformën elektronike nuk ka mundur ti hasi. Por A testet figurojnë në platformën elektronike të cilat i ka bashkangjitur OE i rekomanduar për kontratë pas hapjes së ofertave, A testet janë bashkangjitur me datë: 14.07.2023 dhe për mendimin e ekspertit shqyrtues pranimi i A testeve në formë të tillë përben ndryshmi substancial dhe material.

Ndërsa AK me datë: 25.07.2023 përmes B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarim nga OE fitues vetëm për dy projektet e më poshtme: citoj pyetjet e AK –së:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimi tenderit të juaj si në vijim:

Kerkojm nga ju qe te na ofroni dëshmi kontratën dhe dëshmi nga banka per projek "Furnizim me pajisje per bujqësi dhe blegtori" (OE Famis-CO-HC).
Kerkojm nga ju qe te na ofroni dëshmi kontratën dhe dëshmi nga banka per projek "Furnizim me koshere per blete" (OE Komtel Project Engineering)

Sipas letrës standarde B47, AK nuk ka kërkuar sqarime për A-teste dhe pranimi i A testit nga OE pas hapjes së ofertave sipas LPP – Neni 72 Dokumentacionidhe informacionishtesë. 3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. RRUOPP: 39.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet. 39.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

- Andaj, ky pretendim ankimor nga "Bletaria Egzoni" është i bazuar për ekspertin shqyrtues.

Sa i përket pretendimit ankimor të parashtruar nga "Bletaria Egzoni" Gjakovë lidhur me neni 10.3 të LPP –së se AK nuk ofruar dokumentacionin rreth kërkesa eventuale për sqarime. Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe verifikimit në sistemin elektronik (e-prokurimi) vërejmë se OE ankues ka bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me datë: 18.07.2023 përmes e-malit ku AK ka ofruar qasje konform nenit 10 të LPP –së dhe duke u bazuar se në proces verbalin i cili është mbajtur nga AK ku potencohet edhe në proces verbal se Operatorit Ekonomik, (citojmë pjesën e fundit të procesverbalin), "OE si kopje mori dokumentacionin me ane të USB për të gjithë OE që ka ofertuar ne ketë aktivitet të prokurimit, ashtu siç e ka kërkuar me anë të kërkesës" po ashtu proces verbali është nënshkruar nga dy palët dhe nënkupton se OE ka pranuar dokumentet konform kërkesë së bërë.

- Duke u bazuar në të gjitha pikat e larë përmendura dhe fakteve në sistemin elektronik ky pretendim ankimor për ekspertin shqyrtues është i pa bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimore, operatori ekonomik "Bletaria Egzoni" Gjakovë më tej si parashtrues i ankesës lidhur me kërkesë e dosjes së tenderit tek pjesa Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 është kërkuar: **Kapaciteti teknik dhe professional** 1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 22 500 euro. Ne rast te grupit lideri duhet ti ketë se paku 60 % te shumes se kërkuar furnizime te natyrës se ngjajshme **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** 1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te përcjella me referenca përkatëse ose proceset e pranimeve për projektet e përfunduara – kopje. Duke u bazuar në kërkesë e FDT, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar një listë të projekteve si dhe referencat në fjalë ku në FDT nuk është kërkuar që për referenca të lëshuara nga OE (privat) ti bashkëngjiten edhe transaksionet bankare dhe po ashtu është kërkuar kontrata të natyrës së ngjajshme jo specifike. Por AK pasi ka kthyer procedurën në ri vlerësim për mes letrës B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarim nga OE të datës: 25.07.2023 ka kërkuar nga OE ti sjell kontratën dhe dëshmitë bankare për projektet:

1. "Furnizimi me pajisje për bujqësi dhe blegtori" (OE Famis –CO-HC)
2. "Furnizim me koshere për bletë" (OE Komtel Projekt Engineering).

Operatori ekonomik është përgjigjur dhe ka ofrua dëshmi shtesë kontrata, farura si dhe transaksionet bankre, sa i përket pjese sa a janë kontrata fiktive për verifikim kjo është në diskrediton të AK –së (komisionit të vlerësimit dhe ZPP). Andaj për mendimin e ekspertit ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Duke u bazuar në të gjitha pretendimet ankimore konkretisht në pretendimin e parë ankimor dhe pas shqyrtimit të tyre për mendimin e eksperti shqyrtues kjo lëndë duhet të kthehet në Ri vlerësim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.T.P.„Bletaria Egzoni"**

Shkelzen Hoxha